



PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT

18 SHTATOR - 12 TETOR 2018	Në sekretaritë mësimore të fakulteteve të kryhet regjistrimi me dokumentacion i kandidatëve që kërkojnë të aplikojnë në programet e studimit të ciklit të dytë nga ora 8.00-16.00.
DERI NE 22 TETOR 2018	Shpallen listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, në faqen e web të UE të ndarë sipas programeve të studimit të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluar nga aplikantët.
25 - 30 TETOR 2018	Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues pranë sekretarive mësimore përkatëse.

1 Nëntor 2018 Publikohet lista emërore e kandidatëve fitues të regjistruar.

DOKUMENTACIONI PËR REGJISTRIMIN

Kandidatët do të dorëzojnë personalisht, dokumentacionin e mëposhtëm:

- 1. Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, te ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë.** Diplomë të ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve në vendin përkatës;
- 2. Kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet e ciklit të parë dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara për ciklin përkatës të studimit konform kuadrit ligjor në fuqi, por që nuk disponojnë ende kartonin e diplomës në momentin e aplikimit, pajisen me dokument nga IAL-ja ku kanë përfunduar studimet konform përcaktimeve të pikës 4 të nenit 91 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".** Për diplomat e fituara jashtë vendit, vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar nga MAS, të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduara jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës;
- 3. Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA).** Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose në rast fotokopjeje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore DAR/ZA);
- 4. Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme** ku kanë përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësia përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i shtetit së bashku me listën e notave;
- 5. Kandidatët që kanë kryer shkollën e mesme jashtë shtetit duhet të dorëzojnë dokumentin e njohjes të lëshuar nga MAS;**
- 6. Formulari i aplikimit;**
- 7. Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);**
- 8. Dy fotografi personale;**
- 9. Mandat pagese e tarifës së regjistrimit prej 2500 lekësh.**